

KOSOVA:

Mes mosnjohjes universale dhe 'çnjohjeve'

Korrik, 2020



Ky projekt është i mbështetur nga: Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS)

Autor: Eugen Cakolli

COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI) dhe Fondacioni Konrad Adenauer.

Instituti Demokratik i Kosovës dhe Fondacioni Konrad Adenauer i kanë të gjitha të drejtat e rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org

Qëndrimet e paraqitura në këtë punim nuk paraqesin domosdo qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.

Përmbajtja

HYRJE	4
PRAPAVIJA TEORIKE E NJOHJES SË SHTETEVE SIPAS SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE	5
Njohja dhe llojet e saj	7
Koncepti i “çnjohjes” së shteteve	9
PREJ MUNGESËS SË NJOHJEVE TEK ÇNJOHJET E KOSOVËS	13
Ndikimi i mosnjohjes universale në konsolidimin e shtetësisë së Kosovës	14
Nga dialogu teknik Kosovë-Serbi tek një marrëveshje eventuale për njohje reciproke	16
“Çnjohjet” e proklamuar nga Serbia dhe ndikimi i tyre	19
PËRFUNDIME	23

HYRJE

Njohjet e shteteve kanë qenë pjesë e pandashme e zhvillimeve në të drejtën ndërkombëtare për më shumë se 250 vite. Që nga shfaqja e entiteteve territoriale në Evropë gjatë shekujve XVII dhe XVIII, shtetet filluan të njihnin ekzistencën e shteteve tjera përmes krijimit të raporteve diplomatike me to. Por, me rritjen së numrit të shteteve të formuara jashtë procesit të dekolonializimit, përkatësisht të formimit të shteteve si rezultat i parimit të vetëvendosjes, në shprehje ka ardhur edhe procesi i çnjohjeve. Ky proces, përkundër efekteve të shumta negative në planin e brendshëm të shteteve pretenduese, ashtu edhe në politikën ndërkombëtare, nuk është i rregulluar formalisht nga asnjë instancë apo ligj ndërkombëtar. Në mungesë të një rregullimi, çnjohjet janë duke u përdorur gjithnjë e më shumë nga shtetet për të minuar legjitimitetin dhe personalitetin juridik ndërkombëtar të shteteve të krijuara njëanshëm.

Edhe pse Organizata e Kombeve të Bashkuara juridikisht nuk e ka kompetencën e njohjes së shteteve, anëtarësimi i shteteve në këtë organizatë shihet gjerësisht si arritje e njohjes universale. Pranimi i shteteve në OKB, edhe nëse kundërshtohet nga shtete të caktuara, përveç anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, ka efekt automatik njohës dhe konkludues të procesit të shtetndërtimit. Meqenëse Kosova nuk ka arritur të sigurojë njohje universale, përkatësisht nuk ka arritur të jetë anëtare me të drejta të plota e OKB-së, ajo është detyruar të zgjedhë njohjet individuale, si formë e arritjes së njohjes së konsoliduar ndërkombëtare. Përveç zbatimit të kësaj strategjie, e cila është mjaft sfiduese dhe e vështirë sidomos për shtetet e sapokrijuara, Kosova është përballur edhe me një fushatë agresive të çnjohjeve nga ana e Serbisë. Kjo fushatë, e zhvilluar gjatë periudhës kur palët kanë qenë të angazhuara në një proces dialogues, i cili ka filluar qysh nga viti 2011 nën lehtësimin e BE-së, ka acaruar dhe tensionuar raportet mes dy vendeve. Fushata ka rezultuar edhe me stagnim të procesit integruar të Kosovës, duke vënë në pah nevojën që të gjitha përpjekjet


për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare mes dy vendeve, të jenë të koncentruara drejt njohjes reciproke.

Me anë të këtij punimi, synohet që në radhë të parë të ofrohet një kornizë teorike lidhur me konceptet e njohjes dhe çnjohjeve. Më tutje, punimi trajton sfidat me të cilat është ballafaquar Kosova në raport me konsolidimin e shtetësisë, si pasojë e mungesës së njohjes universale. Tutje, punimi ofron një perspektivë të zhvillimeve dhe evoluimit të procesit të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, që nga fillimi i procesit teknik e deri tek përpjekjet për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare, si dhe ndërlidhjen e procesit të dialogut me njohjen ndërkombëtare, përkatësisht mosnjohjen, të Kosovës. Punimi gjithashtu adreson ndikimin që kanë pasur çnjohjet e proklamuar nga ana e Serbisë në konsolidimin ndërkombëtar të Kosovës.



**PRAPAVIJA TEORIKE E
NJOHJES SË SHTETEVE
SIPAS SË DREJTËS
NDËRKOMBËTARE**





Sipas Konventës së Montevideos (1933) katër kualifikimet që duhet t'i posedojë shteti, si aktor i së drejtës ndërkombëtare, janë:

A
popullsia e përhershme

B
territori i definuar

C
qeveria

D
kapaciteti për të hyrë në marrëdhënie me shtetet tjera.

Zhvillimi dhe evoluimi i koncepteve lidhur me shtetin si subjekt i së drejtës ndërkombëtare ka shtruar shpeshherë nevojën për përcaktimin e kritereve të shtetësisë, në mënyrë që të ketë limite dhe specifika formale për shtetet që mëtojnë njohje ndërkombëtare. Hapi i parë drejt një përcaktimi të tillë ishte organizimi i Konferencës së Shtatë Ndërkombëtare të Shteteve Amerikane në vitin 1933. Në këtë konferencë, 16 shtetet pjesëmarrëse nënshkruan traktatin, që njihet si Konventa e Montevideos¹, e cila për herë të parë kodifikoi kriteret klasike të shtetësisë. Sipas këtij traktati, katër kualifikimet që duhet t'i posedojë shteti, si aktor i së drejtës ndërkombëtare, janë: a) popullsia e përhershme; b) territori i definuar; c) qeveria; dhe d) kapaciteti për të hyrë në marrëdhënie me shtetet tjera.

Popullsia e përhershme, si kualifikim kyç i shteteve, nuk përmban kritere specifike lidhur me madhësinë, natyrën, nacionalitetin apo të ardhurat e popullsisë.

Popullsia e përhershme si kualifikim, nënkupton ekzistencën e një komuniteti stabil në një bazë fizike.² Sa i përket territorit të definuar, si kualifikim tjetër, kjo ndërlidhet me aftësinë e shteteve për të ushtruar sovranitet efektiv mbi një vend të caktuar, pavarësisht faktit se për çfarë madhësie të territorit bëhet fjalë. Në anën tjetër, qeveria, si kriter i shtetësisë, konsiston në kapacitetin që ka një autoritet politik për ushtrimin e pushtetit efektiv dhe të pavarur mbi popullsinë e territorit të caktuar. Edhe në këtë rast, nuk mund të paragjykohet forma e rregullimit shtetëror, apo regjimi politik që ushtrohet brenda shtetit. I fundit, por jo nga rëndësia, është kapaciteti i shteteve për të hyrë në marrëdhënie me shtetet tjera, që nënkupton kapacitetin shtetëror për të zbatuar obligimet e marra ndërkombëtare nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.

Këto kritere kanë kuptim vetëm nëse ekzistojnë si tërësi dhe të ndërvarura nga njëra-tjetra. Mungesa e cilitdo kualifikim, sipas të drejtës ndërkombëtare,

1 Neni 1, Montevideo Convention on the Rights and Duties of States (1933). Montevideo, Uruguay.

2 Crawford, J. (2019). *Brownlie's Principles of Public International Law*. United Kingdom: Oxford University Press. Fq. 192

pamundëson ekzistimin apo formimin e një shteti. Sidoqoftë, shumë autorë kanë vënë theks mbi nevojën që kriteret e shtetësisë dhe njohjes, të jenë më gjithëpërfshirëse dhe të përditësuara, bazuar në zhvillimet gjithnjë e më dinamike në të drejtën ndërkombëtare. Disa prej kriterëve tjera që kanë zënë vend në doktrinat që trajtojnë këtë çështje në aspektin meritator, janë vetëvendosja, demokracia, të drejtat e minoriteteve dhe 'legjitimiteti' kushtetues.³

Përgjatë viteve të 90-ta, si rezultat i situatës së krijuar në ish Republikën Federative Socialiste të Jugosllavisë, Komuniteti Evropian dhe shtetet anëtare të asaj kohe, gjatë Konferencës Ndërkombëtare për Paqe në Jugosllavi, ishin dakorduar për krijimin e Komisionit të Arbitrazhit. Ky komision, që sipas autorëve të shumtë, ishte i jashtëzakonshëm për nga rëndësia, por i pazakontë për nga natyra, do të ishte përgjegjës për ofrimin e opinionëve, që do të shërbenin pastaj si parime për çështjet e shtetësisë dhe suksesionit. Opinionet e këtij komisioni, që njihen ndryshe edhe si "Parimet e Badinterit", kishin shërbyer që disa praktika të deriatëhershme që ishin jo koherente dhe kontradiktore mes vete, të rregullohen nga aspekti i racionalizimit ligjor.⁴ Synimi kryesor i këtyre parimeve ishte ndarja e parimit të vetëvendosjes dhe territorialitetit prej parimit etnik të formimit të shteteve. Opinioni i parë i Komisionit, kishte rikonfirmuar botëkuptimin e deri asokohshëm të kriterëve të shtetësisë, duke definuar shtetin si "komunitet që konsiston në një territor dhe popullsi, që janë subjekt i organizimit të një autoriteti politik".

Përkundër ekzistimit të këtyre kriterëve bazë të shtetësisë si rezultat i dinamikës së ndryshme të funksionimit të shteteve në dekadat e fundit, autorë të shumtë argumentojnë se edhe njohja paraqet element esencial që i jep kuptim ekzistimit të shteteve.⁵ Sipas Lauterpacht, kushti kryesor, mbase i vetëm i njohjes së shteteve është efektiviteti i

pushtetit të ushtruar në atë shtet si dhe pavarësia aktuale prej shteteve tjera. Sipas tij, kushtet tjera janë pothuajse irelevante lidhur me qëllimin dhe natyrën e vet konceptit të njohjes.⁶ Në parim, vetëm shtetet që njohin njëra tjetrën mund të arrijnë marrëveshje të njohura ndërkombëtarisht, nga të cilat rrjedhin edhe obligime të caktuara.

Njohja dhe llojet e saj

Deri në fillim të shekullit të 20-të, në botë ishin të njohura vetëm rreth 50 shtete. Brenda një shekulli zhvillimesh, që përfshijnë edhe dy luftërat botërore, numri i shteteve të krijuara pothuajse është katërfishuar.⁷ Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, si rezultat i procesit të dekolonializmit, parimit të vetëvendosjes dhe shpërbërjes së shteteve, janë krijuar mbi 100 shtete të reja, duke bërë që kjo periudhë të njihet si "Epoka e Secesionizmit". Krijimi i shteteve të reja ka sjellë në vazhdimësi dilemën se a paraqet kjo një situatë faktike apo ligjore. Në fakt, përgjigja e kësaj dileme përcakton edhe rëndësinë e njohjes së shteteve. Nëse krijimi i shteteve shihet ekskluzivisht si krijim i një situatë faktike, atëherë njohja e tij shndërrohet në faktor relativisht të parëndësishëm dhe jopërcaktues. Rëndësia e njohjes rritet pothuajse proporcionalisht me kalimin prej krijimit të shteteve si çështje faktike tek krijimi i shteteve si çështje ligjore. Për shkak të këtyre pikëpamjeve, janë krijuar teoria deklarative dhe ajo konstituive, që në esencë tentojnë të ofrojnë përgjigje në pyetjen se a mund të ekzistojë një shtet pa njohje ndërkombëtare.


3 Grant, T. (1999). *The Recognition of States: Law and Practice in Debate and Evolution*. Westport: Greenwood Publishing Group. Fq. 84.

4 Craven, M. (1996). The European Community Arbitration Commission on Yugoslavia. *British Yearbook of International Law*, Volume 66, Issue 1. Fq. 334-336.

5 Shaw, M. (2008). *International Law*. New York: Cambridge University Press. Fq. 198-199

6 Lauterpacht, H. (2012). *Recognition in International Law*. United Kingdom: Cambridge University Press. Fq. 26-31.

7 Crawford, J. (2007). *The Creation of States in International Law*. New York: Cambridge University Press. Fq. 4



Deri në fillim të shekullit të **20-të**, në botë ishin të njohura vetëm rreth **50 shtete**.

Brenda një shekulli zhvillimesh, që përfshijnë edhe dy luftërat botërore, numri i shteteve të krijuara pothuajse është **katërfishuar**.

Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, si rezultat i procesit të dekolonializmit, parimit të vetëvendosjes dhe shpërbërjes së shteteve, janë krijuar mbi **100 shtete** të reja, duke bërë që kjo periudhë të njihet si **"Epoka e Secesionizmit"**.

Teoria deklarative e shtetësisë, që është normuar edhe me anë të ligjeve ndërkombëtare, e redukton njohjen mes shteteve në formalitet, meqenëse vendosë theks të shtuar tek pohimi që ekzistenca e shteteve të reja është situatë faktike, andaj, njohja është vetëm pranim i situatës faktike. Një botëkuptim i tillë materializohet edhe në kuadër të Konventës së Montevideos, e cila në nenin 3 të saj, thekson që:

*"Ekzistenca politike e Shtetit është e pavarur nga njohja nga shtetet e tjera. Edhe para njohjes, shteti ka të drejtë të mbrojë integritetin dhe pavarësinë e tij, të sigurojë konservimin dhe prosperitetin e tij, dhe rrjedhimisht të organizojë veten ashtu siç e sheh të arsyeshme, të ligjësojë mbi interesat e tij, të administrojë shërbimet e tij dhe të përcaktojë juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave të saj. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk ka kufizim tjetër përveç ushtrimit të drejtave të shteteve të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare."*⁸

Tutje, kjo Konventë, në nenin 6 të saj, i jep karakter të pakthyeshëm vendimit për njohje, duke vlerësuar që *"[...] Njohja është e pakushtëzuar dhe e pakthyeshme."*⁹

Promovues tjerë të kësaj teorie, argumentojnë që shtetësia apo autoriteti i qeverive të reja nuk varet nga pajtimi që jepet nga shteti ekzistues, por bazohet kryekëput në situatën faktike, respektivisht atë paraprake.¹⁰ Autorë të tjerë argumentojnë që diferencat mes këtyre teorive, sidomos lidhur me validitetin e situatave efektive, bartin rrezikun e shndërrimit të së drejtës ndërkombëtare në sistem joefektiv, për shkak të një 'konflikti' fatal mes aspektit legal dhe atij faktik.¹¹ Pra, në parim, bazuar në atë që u përmend më lartë, teoria deklarative mundëson vlerësim objektiv të përbushjes së kriterëve për ekzistimin e shtetit, duke mos kufizuar njohjen vetëm në aspektin e përkufizimeve ligjore ose normative, dhe e njëjta i përgjigjet kërkesave të kohës dhe realitetit ndërkombëtar.¹²

8 Montevideo Convention on the Rights and Duties of States (1933). Montevideo, Uruguaj. E qasshme në: <https://www.ilsa.org/jessup/jessup15/Montevideo%20Convention.pdf>

9 Po aty.

10 Hobach, N., Lefeber, R. & Ribbelink (2007). *Handboek International Recht*. Den Haag: Asser Press. Fq. 8.

11 Crawford, J. (2007). *The Creation of States in International Law*. New York: Cambridge University Press. Fq. 99

12 Gruda, Z. (2013). *E drejta ndërkombëtare publike*. Prishtinë: Fq.79

Në anën tjetër, kritikë të shumtë që promovojnë teorinë konstituive, theksojnë që teoria deklarative redukton njohjen në një formalitet bosh, duke injoruar kështu faktin që akti i njohjes prodhon efekte të rëndësishme ligjore.¹³ Në këtë kuptim, sipas shumë prej tyre, është njohja ajo që kompletton procesin e krijimit të shteteve. Për më shumë, konsiderohet që, marrë parasysh natyrën tërësisht politike të aktit të njohjes, ekzistenca e shteteve nuk mund të relativizohet deri në atë pikë që një shtet të gëzojë njohje nga vetëm një pjesë e shteteve, e më pastaj të mëtojë marrjen e obligimeve dhe të drejtave ndërkombëtare, që në esencë paraqesin personalitetin ndërkombëtar të shteteve.

Përveç teorive që trajtojnë ndikimin dhe karakterin e njohjes në kuptimin teorik, njohjet kanë rëndësi edhe sa i përket llojit apo modelit që vihen në funksion të saj. Ekzistojnë lloje të ndryshme të njohjeve, që ndahen qoftë sipas natyrës juridike të tyre, kuantitetit, subjekteve njohëse e të tjera. Dy llojet kryesore dhe më të cituara të njohjeve janë njohja *de-facto* dhe njohja *de-jure*. Njohja *de-jure*, është njohje e përhershme e cila jepet zakonisht në formë shprehimore nëpërmjet akti formal që dorëzohet nga shteti. Një tip i tillë i njohjes përfshin të gjitha marrëdhëniet mes shtetit të ri të krijuar dhe shtetit njohës. Marrë parasysh natyrën më formale dhe juridike të saj, ky lloj i njohjes është, sipas autorëve, i pakthyeshëm dhe i parevokueshëm.¹⁴ Ndërsa, njohja *de-facto* është kryesisht njohje provizionale që vjen si rezultat i vendosjes së variacioneve të ndryshme të marrëdhënieve mes shteteve, por që nuk është e plotë. Njohja *de-facto* mund të jepet për shtete, qeveri apo kryetarë shtetesh apo për kryengritës dhe palë ndërluftuese, në varësi të zhvillimeve. Ky tip i njohjes nuk është i parevokueshëm, andaj edhe mund të tërhiqet. Rëndom, njohja *de-jure* paraprihet nga ajo *de-facto*.

Përveç natyrës së njohjeve, njohjet mund të tipologjizohen në grupe tjera, në varësi të substancës së vetë aktit të njohjes. Njohjet, ta zëmë, mund të jenë shprehimore ose të heshtura. Njohja

shprehimore jepet me akt të njëanshëm të shtetit njohës, ndërsa njohja e heshtur mund të jepet me akt, i cili jo domosdo është telegram, deklaratë apo notë diplomatike. Në këtë rast, akti mund të ketë edhe formën e veprimit, respektivisht të marrjes së vendimit për lidhjen e marrëveshjeve me shtetin e ri apo vendimit për shkëmbimin e përfaqësuesve diplomatikë. Gjithashtu, njohjet mund të jenë individuale, përkatësisht bilaterale, apo kolektive.

Koncepti i “çnjohjes” së shteteve

Zakonisht, kur shtetet e krijuara njihen nga ana e shteteve tjera, veçanërisht në mënyrë eksplicite, nuk pritet që shtetet të tërheqin vendimin e njohjes, për sa kohë që nuk ka ndryshim substancial në kuptim të përmbushjes së kriterëve të shtetësisë.¹⁵ Formimi i shteteve të reja bazuar në parimin e vetëvendosjes, pa përkrahjen e shteteve përkatëse, ka pasur për rrjedhojë krijimin e shteteve të kontestuara ndërkombëtarisht. Shumica e këtyre shteteve, përkrah përpjekjeve të vazhdueshme për konsolidimin e jashtëm përmes njohjeve, janë ballafaquar edhe me fushata për çnjohje.

Sipas një pjese të autorëve, teorikisht njohjet edhe mund të tërhiqen, duke rezultuar në konceptin e “çnjohjes”, që sipas tyre, ka rol shumë domethënës në politikën botërore.¹⁶ Çnjohjet në parim konsistojnë në tërheqjen, revokimin apo mohimin e vendimit për njohjen e pavarësisë, sovranitetit dhe personalitetit juridik ndërkombëtar të një entiteti. Meqë njohjet, në fund të fundit janë veprime politike, pavarësisht përcaktimeve apo kushtëzimeve ligjore, është në autoritetin e shteteve që t’u vlerësojnë një situatë të caktuar si arsye për tërheqjen e njohjes.¹⁷ Një qasje e tillë përkrah kryesisht nga studiuesit që kundërshtojnë teorinë deklarative të shtetësisë, si dhe deklarojnë që akti i çnjohjes korrespondon zakonisht me interesat politike të shteteve. Çnjohjet zakonisht ndodhin ndaj shteteve me njohje të

13 Kaczorowska-Ireland, A. (2015). *Public International Law*. Fifth Edition. New York: Routledge. Fq. 213

14 Gruda, Z. (2013). *E drejta ndërkombëtare publike*. Prishtinë: Fq.81

15 Kaczorowska-Ireland, A. (2015). *Public International Law*. Fifth Edition. New York: Routledge. Fq. 211

16 Visoka, G., Doyle, J. & Newman, E. (2020). *Routledge Handbook of State Recognition*. New York: Routledge. Fq. 316

17 Shaw, M. (2008). *International Law*. New York: Cambridge University Press. Fq. 468

pjesshme ndërkombëtare, të cilat nuk janë pjesë e OKB-së dhe që nuk kanë përkrahje ndërkombëtare. Disa prej shteteve që janë ballafaquar me fushatë të çnjohjes janë Abkhazia dhe Osetia Jugore nga Gjeorgjia, Kosova nga Serbia, Tajvani nga Kina, si dhe Sahara Perëndimore nga Maroku.

Një qasje e tillë kundërshtohet nga një pjesë e madhe e autorëve, të cilët mes tjerash, deklarojnë që pas pranimit të ekzistencës së një shteti, nuk ka çfarë të tërhiqet më.¹⁸ Kur ofrohet njohje e plotë formale dhe vendosen marrëdhëniet bilaterale, çnjohja nuk mund të ketë efekt retrospektiv në minimin e shtetësisë së shtetit përkatës. Për më shumë, çnjohja nënkupton vetëm që ekzistenca e shtetit pretendues shuhet vetëm në raport me shtetin çnjohës, por jo edhe me shtetet tjera, në sytë e së cilave shteti pretendues vazhdon të ekzistojë si vend i pavarur dhe sovran. Përrjashtim mund të bëjnë vetëm rastet e çnjohjeve kolektive, që mund ta ndikojnë ekzistencën e shtetit dhe pozitës së tij në politikën botërore.¹⁹

Siç u përmend edhe paraprkasht, njohjet *de-facto*, duke qenë një lloj vlerësimi i përkohshëm, mund të tërhiqen në rastet kur, përkundër vendosjes së marrëdhënies, shteti që kërkon njohjen e plotë ka dështuar që të përmbushë parakushtet e shtetësisë, apo në vlerësimin e shtetit njohës, nuk i ka më atributet e të qenit shtet. Çnjohja mund të bëhet përmes akteve formale që shkëmbehen mes shteteve. Në anën tjetër, sa i përket njohjeve *de-jure*, ka polarizim më të theksuar mes autorëve. Shumica e tyre vlerësojnë që njohja bart në vete implikime krejtësisht juridike, e për pasojë, ajo nuk mund të tërhiqet, përveç në rastet kur shteti në fjalë humbet në mënyrë të përhershme ndonjë prejtributeve të shtetësisë.

Krahas dy rrymave klasike të elaborimit të konceptit dhe fenomenit të çnjohjes, një pjesë tjetër e studiuesve, duke marrë parasysh natyrën e parregulluar formale të njohjes dhe çnjohjes, vlerësojnë që këto dy veprime janë tërësisht diskrecionale që shtetet mund t'i vënë në funksion, bazuar në interesat e tyre. Rrjedhimisht, në mungesë

të një dispozite ndaluese ose kufizuese mbi çnjohjet, praktika ndërkombëtare e shteteve do të vijojë të përballet me veprime të kësaj natyre. Megjithatë, vlen të përmendet që tërheqja e njohjes shpeshherë ngatërrohet me prishjen e marrëdhënies diplomatike. Deri sa e para, siç do të elaborohet në pjesët vijuese, është jo-ortodokse në kuadër të marrëdhënies ndërkombëtare, e dyta është më se e zakonshme, pasi që është kryesisht shprehje e mospajtimeve me veprimet e ndërmarra nga ekzekutivi i një shteti të caktuar.

Në historikun e zhvillimeve të marrëdhënies ndërkombëtare, çnjohjet nuk janë të paprecedenta. Hera e parë që ka pasur një vendim formal për "çnjohje" ka qenë rasti i SHBA-ve, të cilat në dhjetor të vitit 1978, nën presidencën e Jimmy Carter, për shkak të zhvillimeve të asokohshme, morën vendim për tërheqjen e njohjes së Tajvanit, duke njohur autoritetin e Republikës Popullore të Kinës edhe ndaj Tajvanit, edhe pse gjatë asaj kohe Tajvani ishte njohur nga mbi 60 shtete.²⁰ Ditëve të sotme, ndryshimet e qëndrimeve lidhur me njohjen, janë kryesisht karakteristike e vendeve të "Botës së Tretë"²¹, të cilat janë shfaqur si rezultat i procesit të dekolonializimit, dhe të cilat i kanë këto veprime aset të vetëm në politikën e jashtme.²²

Sa i përket aspektit procedural të çnjohjes, ndonëse nuk ekziston një përcaktim formal, janë elaboruar tre hapa kryesorë që mund të qojnë drejt një vendimi të tillë. Sipas Visokës, hapi i parë është kontestimi i brendshëm dhe i jashtëm i sovranitetit dhe pavarësisë së shtetit pretendues nga ana e shtetit që ka ushtruar apo ushtron autoritet të pjesshëm mbi të. Së dyti, është procesi i bindjes së shteteve tjera që të rishikojnë vendimet e tyre për njohjen e shtetit pretendues, i cili pasohet nga faza e fundit e çnjohjes, e cila përfshin prishjen e kontakteve

18 Visoka, G., Doyle, J. & Newman, E. (2020). *Routledge Handbook of State Recognition*. New York: Routledge. Fq. 317

19 Po aty. Fq. 318

20 Ling, A. (1983). The Effects of Derecognition of Taiwan on United States Corporate Interests. *Loyola of L.A. International and Comparative Law Review*. Rev. 163. Fq. 163

21 Disa prej shteteve që kanë qenë të përfshira në procesin e çnjohjeve janë Burkina Faso, Republika e Afrikës Qendrore, Republika Dominikane, Gambia, Lesoto, Liberia, Malaii, Nauruja, Panamaja, Ishujt Solomon, Surinami, Tuvalu dhe Vanuatu.

22 Visoka, G., Doyle, J. & Newman, E. (2020). *Routledge Handbook of State Recognition*. New York: Routledge. Fq.322



Sa i përket aspektit procedural të çnjohjes, ndonëse nuk ekziston një përcaktim formal, janë elaboruar tre hapa kryesorë që mund të qojnë drejt një vendimi të tillë. Sipas Visokës:

1

Kontestimi i brendshëm dhe i jashtëm i sovranitetit dhe pavarësisë së shtetit pretendues nga ana e shtetit që ka ushtruar apo ushtron autoritet të pjesshëm mbi të.

2

Procesi i bindjes së shteteve tjera që të rishikojnë vendimet e tyre për njohjen e shtetit pretendues, i cili pasohet nga faza e fundit e çnjohjes, e cila përfshin prishjen e kontakteve diplomatike, ndërprerjen e bashkëpunimit dypalësh, si dhe krijimin e një pozicion neutral ndërkombëtar ndaj shtetit pretendues të njohjes.

3

Në përfundim, ky proces rëndom përmbyllet me dërgimin e një note verbale ndaj shtetit bazë, të cilit qoftë i konfirmohet sovraniteti mbi territorin e kontestuar, apo duke mbajtur një qëndrim neutral ndaj kontestit mes dy vendeve, deri në zgjidhjen paqësore të tij.

diplomatike, ndërprerjen e bashkëpunimit dypalësh, si dhe krijimin e një pozicion neutral ndërkombëtar ndaj shtetit pretendues të njohjes. Në përfundim, ky proces rëndom përmbyllet me dërgimin e një note verbale ndaj shtetit bazë, të cilit qoftë i konfirmohet sovraniteti mbi territorin e kontestuar, apo duke mbajtur një qëndrim neutral ndaj kontestit mes dy vendeve, deri në zgjidhjen paqësore të tij. Në praktikë, baza e arsytimit të çnjohjeve janë përfitimet ekonomike, dinamikat e brendshme politike dhe interesat gjeopolitike.²³ Megjithatë, edhe vet vendimi i çnjohjes mund të revokohet në situata të caktuara, duke rezultuar në rivendosje të marrëdhënieve diplomatike. Ndikimi i çnjohjeve tek shtetet pretenduese është i pamohueshëm, veçanërisht në aspektin politik, ligjor, ekonomik dhe njerëzor. Kjo i atribuohet kryesisht faktit që çnjohjet, sidomos nëse numri i tyre është i madh në proporcion me numrin e përgjithshëm të njohjeve, mund të qojnë në izolim

diplomatik të atyre vendeve.²⁴ Vlen të përmendet që në shumë raste, efekti i çnjohjeve është i lidhur drejtpërdrejtë me arsyeshmërinë e tërheqjes së tyre, të cilat u listuan paraprkisht.

23 Visoka, G., Doyle, J. & Newman, E. (2020). *Routledge Handbook of State Recognition*. New York: Routledge. Fq.322-324

24 Caspersen, N. (2014). Degrees of Legitimacy: Ensuring internal and external support in the absence of recognition. *Geoforum*.



**PREJ MUNGESËS SË
NJOHJEVE TEK
ÇNJOHJET E KOSOVËS**

Ndikimi i mosnjohjes universale në konsolidimin e shtetësisë së Kosovës

Shtetet që nuk kanë gëzuar njohje ndërkombëtare kanë qenë pjesë pothuajse e pandashme e zhvillimeve ndërkombëtare, por arsyet e mosnjohjes janë ato që kanë bërë zakonisht diferencën.²⁵ Mosnjohja është parë shpesh si instrument sanksionues, por edhe si formë presioni ndaj vendeve që supozohet se mund të jenë krijuar përmes veprimeve apo akteve që nuk gëzojnë mbështetje të plotë në normat ndërkombëtare.²⁶ Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në shumë prej vendimeve dhe opinionëve të saj, e ka vlerësuar njohjen si çështje të një karakteri ndërshtetëror. Por, me rritjen e numrit dhe rolit të organizatave ndërkombëtare në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, në kuptim të njohjes së shteteve, autorë të ndryshëm kanë argumentuar lidhur me potencialin e organizatës së Kombeve të Bashkuara si forum i njohjeve kolektive, për arritjen e njohjes universale nga shtete të ndryshme. Në shumë raste, njohja, përkatësisht anëtarësimi në organizata ndërkombëtare është parë gjerësisht si formë kryesore drejt arritjes së njohjes universale, marrë parasysh edhe kompleksitetin në rritje të rendit ndërkombëtar.

Kosova ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008, në koordinim me pjesën më të madhe të faktorit ndërkombëtar, përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet kryesore të Bashkimit Evropian. Shpalljes së njëanshme të pavarësisë, i parapriu një proces negociator disa-vjeçar i udhëhequr nga Kombet e Bashkuara, përkatësisht nga i dërguari i posaçëm i Sekretarit të OKB-së, Martti Ahtisaari. Ky i fundit, në propozimin e tij gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, kishte ofruar pavarësi të mbikëqyrur, propozim ky i cili ishte refuzuar nga Serbia, si dhe aleatët e saj kyç, Rusia dhe Kina, të cilat kishin kërcënuar me përdorim të vetos në Këshillin e Sigurimit ndaj këtij propozimi. Në tetor të vitit 2008, Serbia inicioi një rezolutë, e cila u miratua në Asamblenë

e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, me anë të së cilës u kërkua nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë një opinion këshilldhënës lidhur me përputhshmërinë e deklaratës së pavarësisë së Kosovës me të drejtën ndërkombëtare. Sidoqoftë, përkundër sfidimit të legalitetit të shpalljes së pavarësisë në GjND nga Serbia, Kosova kishte arritur që, prej shpalljes së pavarësisë e deri në publikimin e opinionit të Gjykatës në vitin 2010, të sigurojë 69 njohje, që përbën më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të njohjeve. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, më 22 korrik të 2010 kishte lëshuar opinionin e saj këshilldhënës, i cili vlerësonte që deklarata e pavarësisë nuk kishte shkelur asnjë normë të aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë të drejtën ndërkombëtare si të tillë, Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, si dhe Kornizën Kushtetuese të Kosovës.²⁷ Përkundër pritjeve që opinionin i GjND-së do t'i hapte rrugë njohjeve të reja nga vendet që deri atëherë kishin hezituar ta merrnin një vendim të tillë, Kosova kishte arritur të siguronte vetëm tri njohje gjatë atij viti, si dhe 12 njohje tjera gjatë vitit pasues. Gjithashtu, duke qenë se GjND-ja, sipas procedurave juridike është e obliguar që mendimin këshilldhënës t'ia kthejë institucionit që e ka kërkuar atë²⁸, pra, Asamblesë së Përgjithshme, në këtë të fundit ishte miratuar një rezolutë që parashihte fillimin e një procesi të ri të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga BE-ja, me qëllim të normalizimit të raporteve dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve të të dy vendeve.

Mungesa e njohjeve nga pesë shtete anëtare të BE-së²⁹ ka pasur ndikim të konsiderueshëm edhe në qasjen e përdorur nga ana e BE-së ndaj shtetësisë së Kosovës, dhe angazhimit të saj për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale me këtë të fundit. Duke qenë se sfera e politikës së jashtme të shteteve të BE-së mbetet kompetencë tërësisht ekskluzive e

25 Caspersen, N. (2012). *Unrecognized States*. Cambridge: Polity Press. Fq. 27

26 Shaw, M. (2008). *International Law*. New York: Cambridge University Press. Fq. 470

27 Për më shumë, shih Opinionin Këshilldhënës të GjND-së lidhur me pajtueshmërinë e Deklaratës së Njënashme të Pavarësisë së Kosovës me të drejtën ndërkombëtare. E qasshme në: <https://www.icj-cij.org/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf>

28 Summers, J. (2011). *Kosovo: A precedent? The Declaration of Independence, the Advisory Opinion and Implications for Statehood, Self-Determination and Minority Rights*. Boston: Martinus Nijhoff Publishers. Fq. 133

29 Greqia, Qiproja, Rumania, Sllovakia dhe Spanja.



17 shkurt 2008

Shpallja e pavarësisë

Tetor 2008

Miratohet rezoluta në Asamblenë e OKB-së (e iniciuar nga Serbia), që kërkon opinion këshilldhënës lidhur me përputhshmërinë e deklaratës së pavarësisë së Kosovës me të drejtën ndërkombëtare

22 korrik 2010

GJND publikon opinionin e saj këshilldhënës - që konkludon se deklarata e pavarësisë nuk shkelë të drejtën ndërkombëtare, rezolutën 1244 dhe Kornizën Kushtetuese



17 shkurt 2008
22 korrik 2010
69 njohje



22 korrik 2010
31 dhjetor 2010
3 njohje



2011
12 njohje

vet shteteve anëtare, BE-ja ka qenë e cunguar në priorizimin e çështjes së shtetësisë së Kosovës, krahasuar me çështje tjera si konflikti në Ukrainë dhe programi bërthamor i Iranit, të cilat janë konsideruar si prominente nga BE-ja.³⁰ Sidoqoftë, përkundër dallimeve sa i përket statusit të Kosovës, shtetet anëtare të BE-së në disa raste kanë arritur konsensusin e nevojshëm për krijimin e një qëndrimi të unifikuar lidhur me rastin e krijimit të misionit të EULEX-it, nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim, si dhe çështjen e liberalizimit të vizave. Ekzistimi i pesë shteteve jo-njohëse, prej të cilave dy kanë qëndrim më të ashpër karshi shtetit të Kosovës, ka ndikuar që deri më tani, Kosovës të mos i ofrohet një perspektivë e kristalizuar për integrim evropian, krahasuar me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor.

Që nga shpallja e pavarësisë, prioriteti kryesor i Republikës së Kosovës, i materializuar përmes Objektivave Strategjike të Politikës së Jashtme, ka

qenë konsolidimi i shtetësisë përmes avancimit të vazhdueshëm të pozitës ndërkombëtare të Kosovës dhe fuqizimi i përkrahjes ndërkombëtare për njohjen e sovranitetit të Kosovës.³¹ Në këtë drejtim, sigurimi i njohjeve ndërkombëtare është parë si parakusht për konsolidim ndërkombëtar të Kosovës. Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Kosova numëron 116 njohje.³² Kjo përbën 60% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të organizatës së Kombeve të Bashkuara, ndonëse pritsmëritë fillestare kishin qenë për një numër më të madh të njohjeve. Meritat për pjesën më të madhe të njohjeve i mbështetjes dhe lobimit intensiv të shteteve mike dhe diplomacisë proaktive të Kosovës. Megjithatë, për shkak të zhvillimeve të brendshme politike, ekonomisë relativisht të dobët, mungesës së lidhjeve tregtare, kulturore apo politike me vendet tjera, Kosova filloi të humbte perspektivën

30 Armakolas, I. & Ker-Lindsay, J. (2019). *The Politics of Recognition and Engagement*. London: Palgrave Macmillan. Fq. 6.

31 'Objektivat Strategjike të Politikës së Jashtme' (2008). Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës.

32 Për më shumë, shih listën e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të njohjeve ndërkombëtare që ka Kosova. E qasshme në: <https://www.mfa-ks.net/politika/484/lista-e-njohjeve/484>

e bashkëpunimit dypalësh me shumë prej shteteve që njohin pavarësinë e saj.³³ Kësaj i shtohet edhe roli tejet aktiv dhe qasja agresive e Serbisë, e përkrahur nga Rusia, në funksion të delegjitimitimit sa më të madh të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Fakti që Kosova nuk është njohur nga të paktën 2/3 e anëtarëve të OKB-së, prej të cilave dy shtete janë anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, ka ndikuar që vendi të mos gëzojë njohje universale dhe anëtarësim në organizata tjera ndërkombëtare, që do të kontribuonin në konsolidimin e shtetësisë së Kosovës. Ndonëse Kosova në vitin 2009 ishte anëtarësuar në Bankën Botërore (WB) dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar (IMF), si dy organizata pjesë e kuadrit institucional të OKB-së, vendi ka dështuar që të anëtarësohet në 13 agjencitë tjera të specializuara të OKB-së. Madje, në vitin 2015, Kosova për vetëm tri vota kishte dështuar që të siguronte 2/3 e nevojshme për anëtarësim në UNESCO. Ky dështim kishte ndikuar negativisht edhe në aplikimet tjera, të cilat ndonëse ishin paralajmëruar që do të bëheshin pas asaj periudhe, ishin pezulluar për shkak të frikës së dështimit.

Mosnjohja universale ka bërë që diplomacia kosovare të jetë e fokusuar në kërkim të njohjeve individuale nga shtetet, formë kjo nga më të vështirat në marrëdhëniet ndërkombëtare, sidomos për diplomacitë e pakonsoliduara, siç është ajo e Kosovës, e cila pas shpalljes së pavarësisë ishte ndërtuar nga zeroja, si dhe e cila ishte e varur kryesisht nga përkrahja ndërkombëtare e shteteve mike, sidomos SHBA-ve. Sipas studiuesve, diplomacia kosovare ka qenë e rëndësishme në arritjen e përkrahjes ndërkombëtare për njohje, duke bërë të ditura rrethanat mbi të cilat është krijuar shteti, si dhe duke vënë theksin tek përfshirja e shteteve të fuqishme si bashkëpronarë dhe kujdestarë të pavarësisë.³⁴

Sigurimi i njohjeve "të lehta", të siguruara përmes lobimit intensiv të shteteve mike perëndimore, sipas

autorëve të ndryshëm, është diçka që i përket së kaluarës, duke vënë kështu në pah problemet serioze dhe kufizimet në kapacitetet e lobimit vetanak, me të cilat përballet diplomacia kosovare.³⁵ Kësaj i shtohen edhe probleme tjera të natyrës politike, që përfshijnë mungesën e meritokracisë, transparencës dhe profesionalizmit të të emëruarve diplomatik të Kosovës, si dhe zhvillimet tjera të brendshme që kanë ndodhur në Kosovë, duke përfshirë skenat e dhunës në Kuvendin e Kosovës, protestat e dhunshme e të ngjashme, që kanë dëmtuar imazhin e jashtëm të Kosovës.³⁶

Në anën tjetër, shtetet mosnjohëse, në kuptim të arsytimit dhe argumenteve që përdorin ato për mosnjohjen e Kosovës, mund të ndahen në tri grupe: i) shtetet që, për shkak të largësisë gjeografike dhe mungesës së raporteve bilaterale, nuk kanë interes ta njohin Kosovën; ii) ato që nuk e njohin Kosovën për shkak të problemeve të tyre të brendshme; dhe iii) shtetet që nuk e njohin Kosovën për shkak të afërsisë dhe ndikimit që ka Serbia dhe aleatët e saj, apo për shkak të pozicionimit të tyre gjeopolitik.

Nga dialogu teknik Kosovë-Serbi tek një marrëveshje eventuale për njohje reciproke

Pamundësia e kalimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i hartuar në vitin 2007 nga i dërguari i posaçëm i Sekretarit të OKB-së, Martti Ahtisaari, kishte detyruar Kosovën që të ndiqte një rrugëtim të vështirë drejt përmbylljes së procesit të shtetndërtimit, atë të kërkimit të njohjeve individuale të shteteve të ndryshme. Në këtë drejtim, as Opinioni Këshillëdhënës i GjND-së në favor të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, nuk kishte sjellë efektet e pritura. Andaj, në vitin 2010, si rezultat i Rezolutës 64/29 të Asamblesë së Përgjithshme³⁷, Kosova dhe Serbia kanë filluar një proces të dialogut, i cili lehtësohet nga ana e Bashkimit Evropianit.

33 Visoka, G., Doyle, J. & Newman, E. (2020). *Routledge Handbook of State Recognition*. New York: Routledge. Fq.328

34 Newman, E. & Visoka, G. (2018). The Foreign Policy of State Recognition: Kosovo's Diplomatic Strategy to Join International Society. *Foreign Policy Analysis*, 14 (3). pp. 367-378. Fq. 3

35 Armakolas, I. & Ker-Lindsay, J. (2019). *The Politics of Recognition and Engagement*. London: Palgrave Macmillan. Fq. 38-39.

36 Po aty.

37 UN Doc. A/RES/64/298. 9 Shtator 2010.



Pamundësia e kalimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të **Kosovës**, i hartuar në vitin 2007 nga i dërguari i posaçëm i Sekretarit të OKB-së, **Martti Ahtisaari**, kishte detyruar Kosovën që të ndiqte një rrugëtim të vështirë drejt përmbylljes së procesit të shtetndërtimit, atë të kërkimit të njohjeve individuale të shteteve të ndryshme.

Angazhimi i drejtpërdrejtë i BE-së në këtë proces, ndonëse i kundërshtuar nga studiues të ndryshëm mbi baza ligjore ndërkombëtare³⁸, paraqet një qasje të re dhe pragmatike të BE-së në bashkëpunimin me shtete të cilat nuk i njeh formalisht, apo me të cilat zbaton vetëm praktikën e njohjes bilaterale. Politika “angazhim pa njohje” është aplikuar kryesisht me synimin që anashkalohen aspekti sensitiv normativ dhe politik lidhur me njohjen apo mosnjohjen e shteteve.³⁹

Fillimisht, ishin zhvilluar shtatë raunde diskutimesh mes dy vendeve, që kryesisht ndërlidhen me bashkëpunimin rajonal, lirinë e lëvizjes dhe sundimin e ligjit. Në kuadër të procesit teknik, që ishte zhvilluar deri në gjysmën e dytë të vitit 2012, Kosova dhe Serbia kishin arritur marrëveshje lidhur me lëvizjen e qytetarëve, vulat doganore, njohjen e diplomave universitare, regjistrave kadastralë dhe atyre civilë, si dhe menaxhimin e integruar të kufijve.⁴⁰ Këto

marrëveshje, arritën që në masë të konsiderueshme të adresojnë vet qëllimin mbi të cilin ishte iniciuar ky proces, lidhur me promovimin e bashkëpunimit, arritjen e progresit në rrugët përkatëse drejt BE-së dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve.⁴¹ Sidoqoftë, edhe sot e kësaj dite, ekzistojnë vështirësi të ndryshme, kryesisht të karakterit politik, që kanë penguar zbatimin e disa prej marrëveshjeve të arritura.

Strategjia për Arritjen e Njohjes së Plotë Ndërkombëtare të Republikës së Kosovës⁴², e nxjerrë në qershor të vitit 2011, e konsideron procesin e dialogut teknik mes dy vendeve si momentum të ri për Kosovën, meqenëse për herë të parë, në tavolinën e dialogut, Kosova dhe Serbia shihen si pjesëmarrës të barabartë. Por, vet strategjia kishte njohur efektin negativ që procesi i dialogut do të ketë lidhur me njohjen ndërkombëtare të Kosovës. Në kontekstin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, vlen të përmendet që Kosova dhe Serbia, në shkurt të vitit 2012 kishin arritur Marrëveshjen për Përfaqësim

38 Orakhelashvili, A. (2008). Statehood, Recognition and the United Nations System: A Unilateral Declaration of Independence in Kosovo. *Max Planck Yearbook of United Nations Law, Volume 12*. Fq. 36-39

39 Newman, E. & Visoka, G. (2018). The European Union's Practice of State Recognition: Between Norms and Interests. *Review of International Studies*. Fq. 2.

40 Për më shumë, shih të gjitha marrëveshjet e arritura mes Kosovës dhe Serbisë në modulën e dialogut në platformën Vota Ime: <http://votaimo.org/Public/Dialog>

41 Armakolas, I. & Ker-Lindsay, J. (2019). *The Politics of Recognition and Engagement*. London: Palgrave Macmillan. Fq. 29-30.

42 Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës (2011). *Strategji për Arritjen e Njohjes së Plotë Ndërkombëtare të Republikës së Kosovës*. E qasshme në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIALOBIM\[1\].pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIALOBIM[1].pdf)

dhe Bashkëpunim Rajonal, e njohur ndryshe si Marrëveshja e Fusnotës, e cila kishte mundësuar përfaqësimin e Kosovës në të gjitha takimet dhe organizatat rajonale. Përfaqësimi i Kosovës ishte paraparë të realizohet me deniminimin 'Kosova*', nën të cilin do të aplikohet fusnota e cila përcakton që "ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është një linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës."⁴³

Sidoqoftë, dialogu i nivelit teknik shpejt kishte evoluar në dialog politik, pas takimeve të zhvilluara në tetor të vitit 2012 mes kryeministrave të atëhershëm të dy vendeve, Hashim Thaçi dhe Ivica Dačić. Gati gjysmë viti pas takimit të parë, si rezultat i një sërë takimesh mes palëve, më 19 prill të vitit 2013, Kosova dhe Serbia kishin arritur Marrëveshjen e Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve. Kjo marrëveshje, e përbërë nga gjithsej 15 pika, adreson formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, integrimin e strukturave gjyqësore dhe policore paralele në veri të vendit, në sistemin juridik të Kosovës, mbajtjen e zgjedhjeve lokale në vitin 2013 në të gjitha komunat, duke përfshirë edhe ato të veriut, nevojën për intensifikimin e diskutimeve lidhur me energjinë dhe telekomunikacionin, si dhe mos bllokimin e progresit të palëve në rrugët përkatëse drejt BE-së.⁴⁴ Marrëveshja e Parë ishte pasuar nga katër marrëveshje tjera, që ishin arritur mes dy vendeve në gusht të vitit 2015, që kishin të bëjnë me formimin e Asociacionit, çështjen e energjisë, telekomunikacionit si dhe çështjen e Urës së Mitrovicës mbi lumin Ibër. Përkundër pritjeve si dhe planeve zbatuese, që parashihnin zbatimin e këtyre marrëveshjeve gjatë vitit 2016, një pjesë e konsiderueshme e tyre, sidomos ato që kishin edhe implikime politike lidhur me statusin e shtetit të Kosovës, vazhdojnë të mos zbatohen. Përveç moszbatimit, procesi i dialogut është përballur edhe

me zhvillime sporadike dhe incidente të shumta, që shpeshherë kishin ndikuar edhe në pezullimin e tij për periudha të caktuara. Raportet mes vendeve kishin arritur acarimin maksimal gjatë fundit të vitit 2018, kur si rezultat i fushatës agresive të Serbisë, ishte pamundësuar anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL, por edhe paraprakisht në UNESCO. Si rezultat i kësaj fushate, Qeveria e Kosovës kishte vendosur fillimisht tarifë prej 10% ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, tarifë kjo e cila pastaj ishte rritur në 100%. Tarifa ishte përdorur nga Serbia si argument për mospjesëmarrje në procesin e dialogut, duke bërë kështu që të dështojnë iniciativat për rifillimin e tij, si nga ana e vendeve të BE-së, ashtu edhe SHBA-ve. Acarimit të marrëdhënieve mes dy vendeve i ka kontribuar jashtëzakonisht edhe kampanja e Serbisë për tërheqjen e njohjeve të Kosovës nga vende të ndryshme. Kosova në vazhdimësi kishte kërcënuar me largim nga procesi i dialogut, nëse Serbia vazhdon fushatën kundër njohjeve.⁴⁵

Zhvillimet e tilla kishin vënë në pah nevojën e patejkalueshme që procesi të përmbillet në diskutime për njohjen reciproke mes dy vendeve. Kjo ishte bërë e qartë fillimisht në vitin 2017, kur Ministri i atëhershëm i Punëve të Jashtme të Kosovës, gjatë një diskutimi në Parlamentin Evropian, kishte deklaruar që procesi i dialogut është i padobishëm nëse ai nuk do të shpinte tek njohja reciproke.⁴⁶ Një qasje e tillë ishte kundërshtuar nga eksponentë të ndryshëm në Kosovë, të cilët insistojnë që një formë e tillë e dialogimit u ka ofruar mundësi shteteve që të shtyjnë vendimet për njohjen e Kosovës deri në përmbylljen e dialogut.⁴⁷ Megjithatë, përkundër mosnjohjes nga ana e Serbisë, kampanjës së saj për pengimin e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe kampanjës për tërheqjen e njohjeve, argumentohet se Serbia viteve të fundit ka zbutur qëndrimin e saj karshi shtetësisë së Kosovës, si rrjedhojë e marrëveshjeve të arritura në kuadër

43 Për më shumë, shih Aranzhimet lidhur me Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal, konkluzione këto të dakorduara më 24 shkurt 2012. E qasshme në: http://votaimet.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarrveshjes_24shkurt2012_6Ms449yuN6.pdf

44 Për më shumë, shih Marrëveshjen e Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, e vitit 2013. E qasshme në: http://votaimet.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarrveshjes_19prill2013_HGXf5EDTG4.pdf

45 Visoka, G., Doyle, J. & Newman, E. (2020). *Routledge Handbook of State Recognition*. New York: Routledge. Fq.328

46 Armakolas, I. & Ker-Lindsay, J. (2019). *The Politics of Recognition and Engagement*. London: Palgrave Macmillan. Fq. 33.

47 Po aty.

të dialogut teknik dhe atij politik mes dy vendeve.⁴⁸

Çështja e njohjes nuk ishte marrë parasysh as nga ana e BE-së, kryesisht për shkak të mungesës së një qëndrimi unik të vet saj, por edhe për shkak se metodologjia e përzgjedhur për adresimin e problemeve mes Kosovës dhe Serbisë bazohet në të ashtuquajturin ambiguitet konstruktiv. Por, me kalimin e kohës, është bërë çdoherë e më evidente që, sa më shumë që Serbia afrohet drejt BE-së, njohja reciproke do të jetë e patejkalueshme. Në këtë drejtim, rol crucial ka luajtur edhe Gjermania, e cila vazhdimisht e ka përsëritur qëndrimin që Serbia nuk mund të bëhet pjesë e BE-së pa njohjen e Kosovës.⁴⁹ Si rrjedhojë e fillimit të diskutimeve për njohjen reciproke, palët kishin filluar të ofronin opsionet e tyre për arritjen e një qëllimi të tillë. Ndër to, korrigjimi i kufijve, si eufemizëm për idenë e vjetër të ndryshimit të territoreve, si dhe krijimi i një Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe me kompetenca të shtuara, ishin kryesoret. Opsioni i korrigjimit ishte përkrahur edhe publikisht nga presidentët e dy vendeve, përkatësisht Hashim Thaçi dhe Aleksandër Vuçiq.⁵⁰ Megjithatë, asnjë prej këtyre opsioneve nuk kishte gjetur përkrahje të qartë të bashkësisë ndërkombëtare, akterët kryesorë të së cilës kanë pasur qasje ambivalente, me përjashtim të Gjermanisë e cila ka qenë e prerë në qëndrimin e saj kundër prekjes së kufijve.

Procesi i dialogut kishte mbetur pezull deri në vitin 2019, kur, pas përfshirjes së drejtpërdrejtë amerikane, përmes emërimit fillimisht të Matthew Palmer si i dërguar për Ballkanin Perëndimor, e pastaj të ambasadorit Richard Grenell si i dërguar i posaçëm i Presidentit të SHBA-ve për arritjen e paqes mes dy vendeve, procesi ishte dinamizuar ndjeshëm. Po ashtu, që pas zgjedhjeve për Parlamentin

Evropian, edhe vëmendja dhe përfshirja e BE-së është shtuar, sidomos pas emërimit të Miroslav Lajçak si përfaqësues special i Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri. Si rezultat i përfshirjes amerikane, palët kishin arritur tri marrëveshje në formë të letrave të interesit, lidhur me hekurudhën, autostradën dhe linjën ajrore mes dy vendeve. Po ashtu, në fund të muajit qershor ishte paraparë zhvillimi i një takimi mes delegacioneve të dy shteteve në Uashington, ku palët ishte paraparë që të arrijnë marrëveshje, e supozuar në nivelin ekonomik, e që pastaj do t'i hapte rrugë procesit të dialogut politik, të udhëhequr nga BE-ja, përkatësisht Gjermania dhe Franca. Ajo që bie në sy kohëve të fundit është që administrata amerikane, por jo vetëm, ka shtyrë fuqishëm përpara idenë që procesi i dialogut duhet të përmbillet me njohje reciproke mes dy vendeve.⁵¹ Një qasje tillë është mirëpritur nga institucionet në Kosovë⁵², por është kundërshtuar nga autoritetet në Beograd⁵³, ndonëse jo kategorikisht si më parë.⁵⁴

“Çnjohjet” e proklamuar nga Serbia dhe ndikimi i tyre

Paralelisht me pamundësinë e sigurimit të njohjes universale ndërkombëtare dhe sigurimit të njohjeve të reja⁵⁵, Kosova që nga viti 2017 është ballafaquar edhe me një fushatë të Serbisë, për tërheqjen e

48 Newman, E. & Visoka, G. (2018). The Foreign Policy of State Recognition: Kosovo's Diplomatic Strategy to Join International Society. *Foreign Policy Analysis*, 14 (3). pp. 367-378. Fq. 19

49 Për më shumë, shih lajmin: <https://www.reuters.com/article/us-kosovo-germany-serbia/serbia-must-accept-kosovo-independence-to-join-eu-german-foreign-minister-idUSKCN1FY329>

50 Për më shumë, shih lajmin: "Serbia, Kosovo presidents broach border changes for historic deal". I qasshëm në: <https://www.politico.eu/article/aleksandar-vucic-hashim-thaci-serbia-kosovo-balkans-eu-enlargement-alpbach-forum/>

51 Për më shumë, shih: <https://www.state.gov/joint-statement-of-special-presidential-envoy-richard-grenell-ambassador-philip-kosnett-and-special-representative-for-the-western-balkans-matthew-palmer-on-kosovo/>, <https://europeanwesternbalkans.com/2019/02/15/trump-supports-mutual-recognition-new-letter-vucic-thaci/>, <https://balkaneu.com/pompeo-mutual-recognition-based-on-normalization-of-serbia-kosovo-relations/> dhe <http://rs.n1info.com/English/NEWS/a612782/US-envoy-in-Kosovo-Dialogue-will-end-in-mutual-recognition.html>

52 Për më shumë, shih: <https://www.aa.com.tr/sq/balkani/hoti-objektiv-i-kosov%C3%ABs-n%C3%AB-dialog-me-serbin%C3%AB-%C3%ABsht%C3%AB-njohja-reciproke/1872271>

53 Për më shumë, shih: <https://www.rferl.org/a/serbia-s-vucic-says-no-recognition-of-kosovo-unless-belgrade-gets-something-too/29803920.html> dhe <http://rs.n1info.com/English/NEWS/a610506/Serbia-s-Vucic-We-won-t-allow-recognition-of-Kosovo-on-US-meeting-agenda.html>

54 Për më shumë, shih: <https://www.aa.com.tr/en/europe/serbian-president-recognizing-kosovo-matter-of-time/1746130>

55 Njohja e fundit e Republikës së Kosovës ka ardhur në shkurt të vitit 2018 nga Barbadosi.



Kosova që nga viti 2017 është ballafaquar edhe me një fushatë të Serbisë, për tërheqjen e njohjeve të Kosovës, sidomos nga shtetet afrikane dhe ato oqeanike.

Tërheqja e parë e njohjes së **Kosovës** kishte ardhur nga **Surinami**, në tetor të vitit 2017, disa ditë para vizitës së ministrit të jashtëm të këtij shteti në **Rusi**.

njohjeve të Kosovës, sidomos nga shtetet afrikane dhe ato oqeanike. Tërheqja e parë e njohjes së Kosovës kishte ardhur nga Surinami, në tetor të vitit 2017, disa ditë para vizitës së ministrit të jashtëm të këtij shteti në Rusi.⁵⁶ Gjatë vitit 2018, njohjet ndaj Kosovës i kishin tërhequr edhe tetë shtete tjera⁵⁷. Në vitin 2019, numri i tërheqjes së njohjeve kishte rënë në pesë shtete⁵⁸, ndërsa në vitin 2020, deri më tani, Sierra Leone pretendohet që ka tërhequr njohjen e Kosovës.

Këto tërheqje kanë ardhur kryesisht nga shtete të regjioneve në të cilat Kosova nuk ka arritur të etablojë një prezencë solide diplomatike, hapësirë kjo e cila më pastaj është shfrytëzuar nga Serbia ose aleatët e saj, përmes formave të ndryshme të ndikimit.⁵⁹ Përkundër disa kundërshtimeve konceptuale që ekspertët të së drejtës ndërkombëtare kanë shfaqur

mbi konceptin e çnjohjes⁶⁰, deri më sot, Serbia pretendon që 18 shtete kanë revokuar vendimet e tyre për njohjen e Kosovës.⁶¹ Këto deklarime janë kundërshtuar në vazhdimësi nga Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës e cila ka mohuar pranimin e çfarëdo note nga shtetet përkatëse për tërheqjen e njohjeve. Po ashtu, ka pasur edhe raste kur tërheqja e pretenduar e njohjes është mohuar edhe nga vet disa prej shteteve.⁶² Guinea-Bissau, ndonëse kishte tërhequr njohjen në fund të vitit 2017, në shkurt të vitit 2018 kishte dërguar një notë verbale për Qeverinë e Kosovës, ku deklaronte se vendimi për tërheqjen e njohjes nuk kishte asnjë efekt ligjor. Liberia është shtet tjetër, zyrtarët qeveritar të së cilit, ndonëse gjatë një vizite në Beograd në qershor të vitit 2018 kishin deklaruar tërheqjen e njohjes, disa ditë pas ishin përgënjeshtuar nga një deklaratë e Qeverisë së Liberisë, e cila kishte riafirmuar

56 Për më shumë, shih lajmin: <https://web.archive.org/web/20180620231944/https://wp.caribbeannewsnow.com/2017/11/02/suriname-revokes-kosovo-recognition-heels-russia-visit/>

57 Burundi, Papua Nju Guinea, Lesoto, Komoros, Dominika, Grenada, Ishujt Solomon dhe Madagaskari.

58 Palau, Togo, Republika e Afrikës Qendrore, Gana, dhe Nauru.

59 Berisha, B. (2019). *Kosovo's recognition in face of Serbia's sponsored de-recognition campaign: A summary report*. Prishtina Institute for Political Studies. Fq. 9-10.

60 Për më shumë, shih: <https://kallxo.com/gjate/analize/cn-johja-e-kosoves-a-e-ekziston-dicka-e-tille/>

61 Për më shumë, shih lajmin: <http://www.mfa.gov.rs/en/press-service/statements/19195-minister-dacic-addresses-the-students-of-law-and-political-sciences-faculties-gour-national-priority-is-to-reach-a-political-solution-for-kosovo-and-metohijaq>

62 Berisha, B. (2019). *Kosovo's recognition in face of Serbia's sponsored de-recognition campaign: A summary report*. Prishtina Institute for Political Studies. Fq. 11.



Çnjohja më problematike është ajo e **Sao Tome dhe Principes**. Edhe pse Këshilli i Ministrave të këtij shteti në vitin 2012 kishte miratuar një rezolutë për **njohjen e Kosovës**, vendimi ishte konsidruar si jo valid nga Presidenti i këtij vendi në fillim të vitit 2013, duke vënë kështu dyshime se a ka pasur njohje zyrtare ndonjëherë nga ky shtet apo jo.

marrëdhëniet bilaterale me Kosovën.⁶³ Çnjohja më problematike është ajo e Sao Tome dhe Principes. Edhe pse Këshilli i Ministrave të këtij shteti në vitin 2012 kishte miratuar një rezolutë për njohjen e Kosovës⁶⁴, vendimi ishte konsidruar si jo valid nga Presidenti i këtij vendi në fillim të vitit 2013, duke vënë kështu dyshime se a ka pasur njohje zyrtare ndonjëherë nga ky shtet apo jo.

Fushata e Serbisë për çnjohjen ndërkombëtare të Kosovës është në fakt pjesë e një strategjie të shtetit serb, i cili në parim synon delegitimimin ndërkombëtar të Kosovës, duke ia pamundësuar kësaj të fundit sigurimin e votave të nevojshme për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, me fokus të veçantë duke synuar që të sigurojnë që "[...] shumica e shteteve anëtare të OKB-së të mos e njohin shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës"⁶⁵. Strategjia e Serbisë kundër njohjeve të Kosovës është e bazuar në elementet e zakonshme

të kundër-diplomacisë së njohjeve të shteteve, që përfshijnë – së pari, pretendimin e një shteti që ka ende sovranitet mbi territorin e shkëputur, së dyti, përpjekjet e vazhdueshme diplomatike për të penguar njohjet bilaterale të territorit të shkëputur dhe anëtarësimin e tij në organizata ndërkombëtare, së treti, parandalimin e legjitimitit ndërkombëtar, si dhe së fundi, ndërmarrja e veprimeve ligjore për kontestimin e shpalljes së pavarësisë nga territori në fjalë.⁶⁶ Fushata e Serbisë është ndihmuar indirekt edhe nga antagonizmat e mëdha që ekzistojnë në mes të fuqive Perëndimore dhe shteteve tjera që e kundërshtojnë dominimin e tyre.

Në anën tjetër, Kosova deri më tani nuk ka hartuar një strategji të mirëfilltë për qasjen ndaj kësaj kampanje, por është limituar kryesisht në lëshimin e reagimeve mohuese të çnjohjeve, apo vendosjen e masave ekonomike ndaj Serbisë. Rol negativ në këtë drejtim ka luajtur edhe heshtja e partnerëve ndërkombëtar të Kosovës karshi fushatës agresive të Serbisë për çnjohjen e Kosovës.

Por, ka pasur raste kur këto tërheqje njohjesh janë ndërlidhur me skandale korruptive, mbi bazën e së

63 Për më shumë, shih lajmin: <https://frontpageafricaonline.com/politics/diplomatic-snafu-liberia-in-row-with-kosovo-after-recognition-of-serbia/>

64 Për më shumë, shih rezolutën: https://web.archive.org/web/20131016112008/http://www.1deputyprimeminister-ks.net/repository/docs/RESOLUCAO_RECOCHE_KOSOVO.PDF

65 Për më shumë, shih lajmin: <https://kossev.info/dacic-sier-ra-leone-18th-state-to-withdraw-kosovos-recognition-pristina-denies/>

66 Visoka, G., Doyle, J. & Newman, E. (2020). *Routledge Handbook of State Recognition*. New York: Routledge. Fq.295



Lidhur me argumentet e **Serbisë** për tërheqjen e njohjeve të **Kosovës**, por edhe ato të shteteve që veçse kanë marrë vendim të tillë, është përdorur pothuajse gjithnjë **dialogu** mes vendeve, proces ky i lehtësuar nga **BE-ja**.

cilave edhe janë marrë vendimet në fjalë.⁶⁷ Në vitin 2019, nga një medium i njohur afrikan, ishte raportuar për një skandal, ku raportohet që Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, ka paguar mbi 300 mijë dollarë për Republikën e Afrikës Qendrore, që kjo e fundit të tërheqë njohjen e Kosovës. Po ashtu, shpeshherë në kuadër të kampanjës serbe për tërheqjen e njohjeve është raportuar për përfshirje direkte të Rusisë, e cila ka arritur marrëveshje për heqjen e vizave, apo edhe marrëveshje për bashkëpunim ushtarak, me disa prej këtyre vendeve që kanë marrë vendim për tërheqjen e njohjes ndaj Kosovës.⁶⁸

Lidhur me argumentet e Serbisë për tërheqjen e njohjeve të Kosovës, por edhe ato të shteteve që veçse kanë marrë vendim të tillë, është përdorur pothuajse gjithnjë dialogu mes vendeve, proces ky i lehtësuar nga BE-ja.⁶⁹ Dialogu është përdorur si pretekst edhe për të vonuar vendimet për njohjen e Kosovës nga shtetet që nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Një veprim i tillë i ka rrënjët teorike tek një prej justifikimeve më të shpeshta për çnjohjet – përpjekjet vendore dhe ndërkombëtare për zgjidhjen paqësore të konflikteve mbi sovranitetin. Në fakt, argumenti kryesor i përdorur nga Serbia në fushatën kundër njohjeve të Kosovës, është që njohja e Kosovës mund të minojë procesin e zgjidhjes së konfliktit dhe dekurajon palët që të arrijnë marrëveshje konsensuale në pajtim me normat dhe ligjet ndërkombëtare.⁷⁰

67 Për më shumë, shih shkrimin e ish-ministrit të Jashtëm të Kosovës, Petrit Selimi, lidhur me skandalet korruptive prapa kampanjës serbe për delegjtimimin e Kosovës. E qasshme në: <https://medium.com/@petrit/serbias-derecognition-campaign-unravelling-as-corruption-scandals-mount-b3a761f65ca5>

68 Për më shumë, shih: <https://www.koha.net/arberi/176038/lidhja-ruse-ne-terheqjen-e-njohjeve-te-kosoves/>

69 Për më shumë, shih vendimet për tërheqjen e njohjes së Kosovës nga Republika e Naurusë dhe Gana. Të qasshme në <http://www.mfa.gov.rs/sr/images/slike/desk-top/3idn221119.jpg> dhe http://www.mfa.gov.rs/en/images/Nota_Ghana111119.jpg

70 Visoka, G., Doyle, J. & Newman, E. (2020). *Routledge Handbook of State Recognition*. New York: Routledge. Fq.325

PËRFUNDIME

Çnjohja dhe mosnjohja e shteteve janë koncepte që zakonisht gjejnë zbatim tek shtetet që veprojnë jashtë sistemit të OKB-së, duke bërë që këto koncepte të kenë rëndësi më të theksuar për to, sesa për shtetet tjera që gëzojnë njohje universale.

Ekziston një ndarje e thellë mes studiuesve të ndryshëm, por edhe të shteteve kryesore në arenën ndërkombëtare, sa i përket legalitetit të shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga Kosova, në kuptim të normave dhe së drejtës ndërkombëtare. Konsekuencat e kësaj ndarje kanë implikuar pashmangshëm edhe çështjen e tërheqjes së njohjes së Kosovës nga shtete të ndryshme, të cilat kanë shfrytëzuar pikërisht argumentet e legalitetit të pavarësisë dhe procesin aktual të dialogut mes dy vendeve për të ndryshuar qëndrimet sa i përket pavarësisë së Kosovës. Lidhur me këtë, as pas opinionit të GJND-së, i cili qartazi kishte konkluduar që deklarata e shpalljes së pavarësisë nuk kishte shkelur asnjë normë ndërkombëtare apo vendore, Kosova nuk kishte arritur të bindë disa shtete, sidomos ato që fillimisht kishin deklaruar se do të merrnin për bazë vendimin e GJND-së, për t'a njohur shtetësinë e saj. Në fakt, tashmë procesi i njohjeve është ndërlidhur me përmbylljen e dialogut nga pjesa më e madhe e këtyre shteteve.

Shteti i Kosovës, i shpallur më 17 shkurt të vitit 2008, nuk gëzon ende njohje universale ndërkombëtare, pasi që nuk ka arritur të anëtarësohet në OKB apo BE, por as në shumicën e organizatave tjera të rëndësishme ndërkombëtare, me përjashtim të Bankës Botërore dhe FMN-së. Mosnjohja nga pesë shteteve anëtare të BE-së, mosnjohja nga dy prej shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit, ka bërë që Kosova, ndryshe nga të gjitha vendet e rajonit dhe më gjerë, të ndjekë strategjinë e njohjeve individuale, strategji kjo më e vështira në konsolidimin ndërkombëtar.

Kosova nuk ka pasur suksesin e dëshiruar as në zbatimin e plotë të Strategjisë për Arritjen e Njohjes së Plotë Ndërkombëtare, që kishte paraparë integrimin e plotë të Kosovës si vend i barabartë në bashkësinë e shteteve të lira. Kjo strategji, tashmë do të duhej veçse të ishte në proces të ndryshimit, për t'iu adaptuar kontekstit aktual të zhvillimeve

ndërkombëtare, pa anashkaluar edhe potencialin e Serbisë dhe aleatëve të saj për të bindur shtete që të tërheqin njohjet ndaj Kosovës, apo të ngadalësojnë procesin e vendimmarrjes për një vendim pozitiv.

Paralelisht me problemin e mungesës së njohjes universale, Kosova është ballafaquar viteve të fundit edhe me një fushatë të Serbisë për tërheqjen e njohjeve për shtetin më të ri në Evropë. Në mungesë të një diplomacie të konsoliduar të Kosovës, si dhe në pamundësi të kësaj të fundit për të thëlluar raportet me shtetet njohëse, Serbia ka arritur që të bindë dhjetëra shtete që të tërheqjen e njohjeve ndaj Kosovës. Kjo fushatë ka qenë e bazuar edhe në raportet dypalëshe dhe shumëpalëshe të Rosisë me vende të shumta, duke influencuar vendimet e tyre për të mos marrë vendim për njohjen e Kosovës, si dhe në raste tjera, për tërheqjen e tyre.

Përkundër qëndrimeve të shumë autorëve lidhur me ekzistencën e mundësisë së tërheqjes së njohjes *de-jure*, fakti që mbi 10 shtete tashmë kanë ndryshuar qëndrim sa i përket njohjes së Kosovës, edhe pse nuk ka efekte të drejtpërdrejta juridike, ka ndikimin në procesin politik të konsolidimit të shtetësisë së Kosovës, sidomos sa i përket anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. E në këtë drejtim, procesi i dialogut teknik me Serbinë, i pasuar edhe nga dialogu politik, e sidomos ajo që është quajtur "faza përfundimtare", paralelisht me fushatën për delegjitimimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare përmes çnjohjeve, është përdorur si argument nga Serbia, përkatësisht aleatët e saj, që të kërkohet pezullimi i vendimeve për njohjen e Kosovës deri në qartësimin përfundimtar të statusit të Kosovës. Po ashtu, procesi i dialogut ka afektuar negativisht edhe marrjen e njohjeve të reja, meqenëse prej shumë shteteve, vendimi për njohjen e Kosovës është kushtëzuar me rezultatin përfundimtar të procesit dialogues mes Kosovës dhe Serbisë.

Prandaj, në këtë drejtim, është esenciale që Kosova të intensifikojë përpjekjet për arritjen e një marrëveshje përfundimtare me Serbinë, potencialisht për njohje reciproke, e cila do të hiqte dilemat tek pjesa dërrmuese e shteteve që nuk e njohin shtetin e Kosovës, mbi bazën e mungesës së pajtimit nga Serbia për shpalljen e pavarësisë.



Kosova Democratic Institute
Bajram Kelmendi N/45
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel/Fax: +381(0)38 248 038
info@kdi-kosova.org



Konrad-Adenauer-Stiftung
Bulevardi Nënë Tereza, 27/3-6
10000 Prishtinë
Tel: +383(0)38 229 874
www.kas.de/kosovo